



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.29, datë20/09/2023

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES
NR.SERIE 0015, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.14, DATË
12.07.2018 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,
SUBJEKTIT “IMLS” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0015, miratuar me Vendimin Nr.14, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X=4396810; Y=4580000; Z=70 m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X=4396889; Y=4580058; Z=76m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=480450.7; Y=4579218.7; Z= 76 m.m.n.d (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=0.6$ l/s
 - Prurja mesatare : $Q_{mes}= 4$ l/s
 - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0015, miratuar me Vendimin Nr.14, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen, “leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare (Import-Eksport, tregëtim produktesh të ndryshëm)”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, Kashar, Bashkia Tiranë.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

